3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimin dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

---

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 1/1.**

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët ]*

---

## FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
---	---	---



---

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					

---

<b>Nëshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Shoqëria Albpetrol sh.a ka nën administrim vendburimet Gorisht, Kuçovë dhe Patos për nxjerrjen e naftës dhe gazit. Punimet e remontit nëntokësor në pjesën më të madhe të puseve të këtyre vendburimeve kompania i kryen me mjetet e saj (Traktorë pastrimi, Autosonda diessel, autosonda elektrike, autongritës elektrik etj.).

Për realizimin e programit të prodhimit të shoqërisë Albpetrol janë të programuar rreth 1202 puse të cilat kërkojnë shërbime të remontit nëntokësor me autosondë pasi traktorët e vjetër me zinxhirë të pastrimit kanë rendiment të ulët pune, konsum të lartë diezeli, nuk janë të pajisur me kullë si dhe pjesët mekanike të traktorave nuk gjenden në tregun vendas për shkak se janë tepër të vjetër si pajisje teknologjike gjithashtu nuk mund të futen në rrugë tështruara me asfalt.

Për kryerjen e punimeve të remontit nëntokësor me synim mbajtjen në punë të puseve për një periudhë sa më të gjatë si dhe vënien në punë të puseve të fondit të ndalur ç'ka do të sillte dhe realizimin e normave të prodhimit, Shoqëria Albpetrol sh.a ka nevojë për 1 (Një)autosondë me kullë me goma me kapacitet ngritës  $\geq 20$  Ton.

---

Vënia e këtyre puseve në punë dhe përmirësimi i koeficientit të shfrytëzimit do të shërbejnë për realizimin e bazës së prodhimit të programuar.

Autosonda do të kryejë punimet në puset me thellësi 1000 -1600 m.

Specifikimet Teknike të Autosondes së Remontit Nëntokësor me kapacitet ngrites të punës normale 20 ton dhe kapacitet ngritës maksimal jo më të vogël se 35 ton.

## **I. Përshkrimi i Përgjithshëm.**

Autosonda e remontit nëntokësor është një agregat shumë kompleks që është integruar mbinjë kamion special në të cilin janë instaluar nëpërmjet një shasie të dubluar të gjitha pajisjet e autosondës së remontit. Konstruktimi i këtij agregati (Autosonda) konsiston në shfrytëzimin maksimal të rendimentit të fuqisë motorrike të motorrit diesel të kamionit special nëpërmjet sistemit të transmesioneve, freksionit të fuqisë, kamios , kutisë hidraulike të konvertimit të fuqisë, arganellos dhe sistemit të saj të frenimit, kutisë së shpejtësisë të arganellos, kullën teleskopike me dy seksione, sistemin e matjes së peshave ngritëse, sistemin elektrik, sistemin hidraulik për lidhjen e kyçeve hidraulike, sistemin e makarasë të nderlidhur me ciplakun + parangon dhelitarin e çelikut që mbështillet në arganello, kompletojnë kështu një makineri të garantuar për ngritjen dhe uljen e tubove dhe purtekave në puset e naftës dhe të gazit.

Kulla e sondës duhet të jete me dy seksione (Double telescopic) e cila komandohet me system hidraulik për ngritjen dhe uljen e seksionit të brendshëm me anë të një pistoni hidraulik.

Këndi normal punës të kullës duhet të jetë  $\leq 5,5$  gradë dhe rregullohet me rregjistër mekanik sipas dëshirës.

Çiplaku i sondës duhet të jetë në modelin e” kutisë së hapur” e cila duhet të jetë e pajisur me gardh mbrojtës.

Arganellua duhet të jetë një trup i vetëm “E modelit single drum” dhe pesha normale e tërheqjes që ajo përballon duhet të jetë  $\geq 200$  kN.

Modeli i ferrotave duhet të jetë “Me ferrota shiriti material të posaçme zjarr-durues” Sistemi hidraulik duhet të jetë funksional për nivelimin e sondës në bazën e pusit, kontrollindhe funksionimin e arganellos, ngritjen dhe uljen e seksionit të brendshëm të kullës, komandimin e freksionit, vënien në punë të kyçeve hidraulike,

Sistemi pneumatic duhet të jete funksional për kontrollin e arganellos, freksionit, sisteme emergjences së frenimit dhe dhe takimin dhe stakimin e levizjes rrotulluese nga motorri i Autosondes drejt makinerisë së saj.

## II. Specifiket Teknike për Autosondën.

Parametrat e Autosondës		Njësia	Limiti	Vlera
Shqip	Anglisht	Matëse		
Pesha Nominale e Kullës në tërheqje	Rated Hook Load	Ton	Min	20
Pesha Maksimale e Kullës në tërheqje	Max. Hook Load	Ton	Min	35
Shpejtësia e Bllokut (Talje)	Max. Hook Speed	m/s	Min	1.5
Fuqia (Motorrike)	Total Power	kW	Min	190
Lartësia e Kullës	Mast Height	m	Min	18
tësia Max. elëvizjes	Max. Speed	Km/h	Min	75
Këndi i kullës	Mast Angle	Gradë	Min	5.5
Rezistenca Ndaj Erës	Wind resistance capacity	Km/h	Min	95
Thellessia e punimeve	Workover Depth	m		1000-1600 (2-7/8") (TS) (EUE)
Akset e ngarjes (Rrota x Rrota Aktive)	Site Drives Form	Nr.	Min	4 x 2
Diametri i litarit të linjës	Wire Line Diameter	mm	Min	19
Këndi max. i ngjitjes në ngarje	Max. Climbing Degree	Gradë	Min	30

- Autosonda duhet të jetë e re e vitit 2023.
- Duhet të jetë e pajisur me kullë me 2 seksione. Lartësia maksimale e kullës  $\geq 18$  m.
- Kulla e Autosondës duhet të përmbushë Standartin API SPEC 4F ose ç' do standart të barazvlefshëm përfshirë standartet Shqiptare.
- Duhet të jetë e pajisur me goma.
- Pesha normale (Nominale) e punës të kullës në tërheqje  $\geq 20$  Ton.
- Pesha maksimale (Statike) e punës të kullës në tërheqje  $\geq 35$  Ton.
- Thellessia e punimeve 1000 - 1600 m (2 7/8") (TS) (EUE).
- Fuqia e motorrit  $\geq 190$  kW.
- Modeli i motorrit të përputhet me ligjet në fuqi mbi normat e emetimit të gazravedhe të jetë me shpejtësi të ndryshueshme të kontrolluar.
- Sistemi i shkarkimit të gazrave të jetë i larguar nga gryka e pusit.
- Sistemi i parangos (taljes) min 2x3.
- Diametri i litarit të arganellos  $\geq 19$  mm.
- Forca max tërheqëse në degën e punës së litarit  $\geq 100$  kN.
- Shasia e autosondës të jetë e dizenuar me minimalisht dy akse.
- Sistemi i lëvizjes të jetë minimalisht Model: 4x2.
- Distanca aksiale midis akseve të Autosondës të jetë  $\leq 5$  m.
- Duhet të jetë e pajisur me sistemin e fikjes të emergjencës.



- 
18. Sistemi i shkarkimit të gazrave duhet të jetë e pajisur me parandalues shkëndije përmbrojtjen nga shpërthimi i zjarrit.
  19. Të jetë i pajisur me sistemin e shkarkimit të ngarkesave elektrike dhe elektrostatiqe.
  20. Të jetë e pajisur me konvertuesi hidraulik i momentit rrotullues (rotor hidraulik):
  21. Rezistenca ndaj ertes me shpejtesi  $\geq 95$  km/h.
  22. Pjerresia maksimale e kullës  $\geq 5,5$  grade.
  23. Peshë maksimale në tërheqje e çipllakut të sondës  $\geq 35$  Ton.
  24. Modeli i freksionit duhet të përmbushë standartin: ATD 218-H; ATD 118-H oseç' do standart të barazvlefshëm, përfshirë standartet Shqiptare.
  25. Diametri i litarit te celikut minimalisht  $\geq 19$  mm.
  26. Parangua e Autosondës dhe Ganxha ngritëse duhet të kenë kapacitet ngritës  $\geq 35$ Ton.
  27. Numri i pulexhove të parangos së Autosondës minimalisht 2.
  28. Ganxha e Parangos ku inkastrohet me parangon duhet të jetë e rrotullueshme 360 gradë.
  29. Autosonda duhet të jetë e pajisur me drillometër (Matësi i peshës) elektronik dhe të ketë ndjeshmëri të lartë treguese.
  30. Autosonda duhet të jetë e pajisur me vinç hidraulik me kapacitet  $\geq 2.5$  Ton dhe të jetë i komandueshëm nga pozicioni i manovratorit me levë komandimi hidraulike ose pneumatike.
  31. Duhet të jetë e pajisur me dalje për lidhjen e kyçeve hidraulike dhe rrotorit hidraulik.
  32. Sistemi hidraulik i sondës duhet të mundësojë funksionimin normal të:
    - a) Nivelimit te sondës.
    - b) Ngritjen dhe uljen e kullës dhe seksionit teleskopik të saj.
    - c) Sigurimin e punës normale të vinçit hidraulik.
    - d) Funksionimin normal të kyçeve hidraulike.
    - e) Funksionimin normal të konvertuesit hidraulik të momentit rrotullues (Rrotorihidraulik).
  33. Pompa hidraulike kryesore duhet që minimalisht të plotësojë kushtet e punës si mëposhtë:
    - a) Volumin  $\geq 160$ L në minimalisht 1800 rrot/min.
    - b) Presionin i punës  $\geq 14$  Mpa (2000 psi).
  34. Sistemi Pneumatik i Autosondës duhet të ketë një presion pune prej  $\geq 0.65$  Mpa dhetë sigurojë furnizimin me ajër për funksionimin normal të:
    - a) Freksionit të motorrit dhe makinerisë.
    - b) Sistemin e kontrollit të freksionit të Arganellos.
    - c) Valvula e kontrollit të emergjencës së arganellos kur parangua kalon zonën ekuqe të sigurisë pranë çipllakut në ngritje.
  35. Autosonda të jetë e pasitur me sistem elektrik 24 V për të bërë të mundur:
    - a) Ndezjen dhe fikjen e motorrit.
    - b) Ushqimin e sinjalistikës së shasisë dhe aparaturave të kontrollit të Autosondës.
    - c) Ndriçimin e autosondes në ambientet e punës të jetë me llamba LED dhe tension 24 V .
  36. Duhet të jetë e pajisur me kyç hidraulik për tubing nga 2-3/8" deri në 3-1/2". Kyçi të jetë i pajisur me gjitha llojet e nollave për të gjitha dimensionet e tubove të sipërpërmendura dhe të gjitha llojet e tubove (EUE dhe NUE).

- 
37. Duhet të jetë e pajisur me elevatore për tubing nga 2-3/8" deri në 3-1/2". Minimalisht nga 1 (Një) elevatore për gjitha dimensionet e tubove të sipër përmendura dhe të gjitha llojet e tubove (EUE dhe NUE).
  38. Duhet të jetë e pajisur me kyç hidraulike për purteka nga 3/4" deri në 1". Kyçi të jetë i pajisur me gjitha llojet e nofullave për të gjitha dimensionet e purtekave të sipër përmendura
  39. Duhet të jetë e pajisur me elevatore për purteka nga 3/4" deri në 1". Minimalisht nga 2 (Dy) elevatore për gjitha dimensionet e purtekave të sipër përmendura.
  40. Duhet të jetë e pajisur me pajisje fshirëse për tubing nga 2-3/8" deri në 3-1/2", (Të gjitha llojet e fshirëseve për të gjitha llojet dhe dimensionet e tubove).
  41. Duhet të jetë e pajisur me pajisje fshirëse për purteka nga 3/4" deri në 1-1/4", (Të gjitha llojet e fshirëseve për të gjitha dimensionet e purtekave).
  42. Duhet të jetë e pajisur me minimalisht 2 (Dy) sete (Palë) krahësh (Braço) për varjere elevatoreve në bllokun e punës.
  43. Duhet të jetë i pajisur me 1 (Një) Ganxhe rrotulluese (Hook Rods) për lidhjen e Ganxhes së parangos së Autosondës me elevatoren e purtekave me kapacitet jo më të vogël se 25 ton.
  44. Duhet të jetë e pajisur me sistem pneumatik (Slips) me kunj mbështetës për tubing nga 2-3/8" në 3-1/2", (Sistemi të jetë i pajisur me të gjitha llojet e kunjave për të gjitha dimensionet e tubove).
  45. Duhet të jetë e pajisur me parrakë anësorë për gjatë gjithë gjatësisë së pozicionit të punës të Kryesondatorit.
  46. Kulla të jetë e pajisur me shkallë për ngjitjen në lartësi.
  47. Të jetë e pajisur me litarë sigurie për ngjitjen e punëtorëve.
  48. Çipllaku i sondës të jetë i pajisur me mbrojtëse.
  49. Duhet të jetë e pajisur me sistem ndriçimi për punën në kushtet e mungesës të ndriçimit natural.
  50. Duhet të jetë e pajisur me sinjalistikat e duhura (akustik dhe vizual) për kryerjen e punimeve në grykë të pusit në mbështetje të sigurimit teknik për mbrojtjen e punonjësve në punë.

Për autosondën si dhe për pajisjet ndihmëse të autosondës duhet të paraqiten certifikatat e inspektimit (testimit) nga fabrika prodhuese. Certifikatat duhet të jenë në standartit API, ISO ose çdo standart i barazvlefshëm përfshirë standartet Shqiptare.

Garancia: 24 (njëzet e katër) muaj nga koha e lëvrimit të mallit. Gjatë kësaj periudhe kontraktuesi detyrohet të zëvendësojë me shpenzimet e tij mallin e reklamuar për arsye të cilësive së prodhimit.

---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

#### **Sasia e mallit që kërkohet:**

Autosonde e Remontit Nentokesor sipas specifikimeve teknike te kerkuara 1(nje) cope.

#### **Afatet e lëvrim:**

Autosonde e Remontit Nentokesor objekt prokurimi 1(nje) cope sipas specifikimeve te kerkuara, do te levrohet jo me vone se **40 dite** nga lidhja e kontrates.

Kontraktuesi duhet te dorezoje autosonden prane Autoritetit Kontraktor, ne QFT Patos ku do te merret ne dorezim nga Komisioni i Marrjes ne Dorezim i ngritur me urdher te posacem.

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituruar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

---

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriteve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Kopje të certifikuar të bilancit për vitin financiar 2022, të shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur është në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilanci, nuk duhet të ketë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

2.2.2. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

---

## **Si deshmi per pervojen e meparshme kerkohen te paraqiten:**

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

### **OSE**

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikaten ISO 9001:2015 ose e përditësuar mbi "Sistemin e menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për artikullin e kërkuar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që verteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.
- 2.3.4. Kataloge teknike/skeda teknike, nga firma prodhuese për autosonden objekt prokurimi. Katalogu/skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të autosondes së bashku me aksesoret përkatës që janë objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në katalogun/et/skeda të paraqitur të shënohen në mënyrë të dukshme lloji i autosondes, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. (Pjesët specifike të katalogut/skedës teknike, ku jepen karakteristikat e mallit që prokurimet nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

#### B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

**Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

**Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit****A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT****Deklarata**

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.



*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_*

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;

është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

çmimet ;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

#### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

